

KOSOVARJA

Ballina: Arbnore Gegollaj
Outfit: Fortesa
Foto: Blend Roka

Shqiptarët
jetojnë për inati
të njëri-tjetrit

Ç'thonë
gratë për
politikanët
tanë

Disa burrave
u shkon jeta
tu rrejt

Arbnore Gegollaj

*estetistja që po shndërrohet
në histori suksesi*

Kujtesa Gashi
– brilante
në fushën
e bukurisë

Realitet:
Fëmijët rrahin
prindërit

Llapiania:
Mos pastë
kush martesë
të zezë si unë

Unioni:
Bizneset
në Gjermani
me peshë
për zhvillimin
e Kosovës



Ç'thonë gratë për politikanët tanë?

Shumë nga gratë e rëndomta ua kanë zili atyre grave që i kanë burrat të famshëm, politikanë. Do të jepnin gjithçka që edhe burri i tyre të ishte i njohur. Por, ka edhe të tilla që nuk duan që burri i tyre të jetë i njohur, por duan të jetë i thjeshtë, punëtor, pa probleme...

V. T., 41 VJEÇE, NGA PRISHTINA:

- Jam e martuar dhe i kam dy fëmijë. Im burrë është profesor. Kurrë nuk do e merrja burrë politikanin. Sepse, po e shihni edhe vetë se si po zhyten ata në korrupsion, në dallavere me tenderë të ndryshëm, të përfshirë në afëra korruptive e të tjera të ngjashme. Thjesht, më pengon fama e burrit, sepse ai pastaj do e ndjej veten lart e unë do mbetëm nën hijen e tij...

Shkurt e shqip: Nuk dua që burri im të jetë në qendër të vëmendjes, por unë. Sepse, po të jetë ai në qendër të vëmendjes, pa dyshim, nuk do të ketë kohë t'më përkushtohet mua, por ndonjë tjetër, me të cilën edhe e lidhë vendi i punës, udhëtimi zyrtar a shoqëria.

Andaj, shqyr Zotit, burrin e kam profesor: shkon në mësim, kthehet pas mësimit te unë në banesë dhe bashkë me fëmijë pasdite dalim në ndonjë vend për të pirë kafe apo edhe në shëtitje.

S. B., 39 VJEÇE, NGA PEJA:

- Do të doja ta kisha burrin të famshëm, bie fjala, të jetë futbollist apo i ndonjë sporti tjetër, por kurrësi politikan, këngëtar a artist. Bie fjala, po të jetë im burrë artist, ai do luajë edhe role të ndry-

shme dashurie. Pra, do të jetë në përfaqim të tjetrës. E, unë të shkoj në teatër e ta shikoj se si puthet ai me tjetrën, a?! Jo, sepse jam xhelozë dhe nuk do toleroja gjëra të tilla kurrë.

Im burrë është inxhinier, ka firmë të veten dhe punon pa ndalur, kështu që edhe punët i kemi mirë. Unë i jam përkushtuar me mish e shpirt vajzës sonë, ajo tash është 5 vjeçe: e dërgoj në çerdhe dhe vetë kthehem në shtëpi e i kryej punët e shtëpisë. Kah ora 14 shkoj në ndonjërin nga kafiteritë që ndodhen afër çerdes së vajzës, takoj ndonjë shoqe, por ka raste edhe ndonjë shok nga shkolla e mesme dhe pi kafe një orë a një orë e gjysmë, deri kur edhe vjen koha që ta marr vajzën nga çerdhja.

Në mbrëmje mua dhe vajzën burri shpeshherë na dërgon në ndonjë restorant për të ngrënë darkë.

L. E., 43 VJEÇE, NGA FERIZAJ:

- Thënë të drejtën, ndoshta pse jam e lindur e rritur në fshat, e që nuk ishim mirë materialisht, nganjëherë më shkon mendja te to dhe them lum ato që i kanë burrat politikanë: kushte të mira po, shëtitje po, verës në det po, vetura luksoze po, ahengje e sorollatje poshtë e lart po. E, çka i duhet njeriut tjetër? Por, ka edhe raste që kur po i dëgjoj në

televizor se si po i shajnë disa nga politikanët tanë që po vjedhin sa po mundin, them me vete: shqyr Zotit që im burrë është punëtor administrate dhe nuk ka çka me vjedhë se ndoshta do të bëhej si ata që i përmenda pak më lart. Sidoqoftë, kur kthehet burri nga puna, unë dhe fëmijët (një vajzë e një djalë e kemi), ulemi bashkë dhe hamë drekë, pastaj ai shikon televizor, kurse unë i laj enët apo ndonjë gjë tjetër. Në mbrëmje, thënë të drejtën, kënaqem duke i shikuar serialet turke dhe jam mishëruar me to. E, për dalje në dreka e darka, siç bëjnë gratë e politikanëve tanë, unë nuk i kam kushtet, por nuk prish punë, edhe pse nuk dal. Shpesh me fëmijë shkoj në familjen time dhe rri nga dy-tri ditë, e fëmijët kënaqen në ajër të pastër, sepse majën e Lybetenit e kemi shumë afër.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Jetë të mirë bëjnë gratë e politikanëve, por edhe problemet i kanë të mëdha: ku shkoi burri, pse nuk erdhi ende burri, sa do të rrijë këtë herë në udhëtim zyrtar, a do e qesin edhe tim burrë në televizor për hajni siç po i publikojnë të tjerët, e të tjera të ngjashme, brenga të cilat gratë e martuara me burra të thjeshtë nuk i kanë. Edhe kjo mjafton, a?

Diturie Haxhaj



+383 45-200-564

dinoqeramika

Dino Qeramika



BREZOVICA
HOTEL & SPA

+383 (0) 49 30 10 30

sales@brezovicahotel.com

brezovicahotel

brezovica hotel





Arbnore Gegollaj

estetistja që po shndërrohet në histori suksesi

Arbnore Gegollaj është estetistja e njohur, puna e shkëlqyer e së cilës shpesh po flet në emrin e saj. Arbnorja ka hapur studion e bukurisë dhe estetikës “Phi Arbnore Gegollaj” në Malishevë dhe falë shërbimeve cilësorë e punës unike, suksesi nuk po i mungon.

Arbnore, një përshkrim të vetes me pak fjalë?

- Kam vetëbesim në aftësitë e mija për të prodhuar suksese, jam e përgjegjshme për çdo gjë dhe përherë marrë përgjegjësi për veprimet e mija kur gjërat ndodh të shkojnë keq. Nuk pres nga forcat e jashtme të më përmirësojnë, por përherë e përmirësoj dhe avancoj veten.

Po, të tjerët si të përshkruajnë?

- Kryesisht, më përshkruajnë si femër e fortë dhe e zonja në punën që bëjë. Andaj, është bukur kur njerëzit të vlerësojnë për atë që je dhe atë që përfaqëson.

E keni pasur ëndërr që në fëmijëri të merreshit me botën e së bukurës.

Më saktë, si e mendoje?

- Mendoja që do të mbetej vetëm një ëndërr, por ja që u bë realitet. Përherë kam menduar se a do të bëhet, a do të realizohet. Më kanë qel mëngjeset duke e ëndërruar këtë që kam sot.

Kush ishte personi që i besoi ëndrrës dhe vizionit tënd?

- Bashkëshorti im, falë të cilit jam këtu ku jam, duke e jetuar ëndrrën time dhe duke punuar në punën që kam dashur ta bëjë gjithmonë.

Cilat janë shërbimet që i ofroni në klinikën tuaj estetike?

- Shërbimet që i ofroj janë një gamë e tërë, duke nisur nga philings, phibright, microbalding, make up, hairstyle, nails, lashes, ngjyrosje etj.

Shërbimi më i veçantë që ofroni?

- Thuajse të gjitha janë shërbime të veçanta, e që realizohen me profesionalizëm dhe pasion. Gjithsesi, do ta veçoja shërbimin microbalding tattoo, që është edhe tejet i kërkuar.

Si ndihen klientet tuaja kur i shohin ndryshimet që u bëhen?

- Ofrojmë punë dhe shërbime cilësore,

andaj edhe klientet përherë ndihen mirë dhe të kënaqura. Mendoj se puna dhe shërbimi i mirë i afron klientet dhe e kundërta e kësaj, pa dyshim, i largon.

Duket se kurrë nuk ka qenë më lehtë për t'u dukur bukur, apo jo?

- Më duhet të pranoj se kjo është e vërtetë. Falë gjithë shërbimeve estetike, secila femër mund të arrijë të duket bukur dhe ashtu siç ka dëshiruar gjithmonë.

A kanë kosto të lartë ndërhyrjet?

- Do të thosha që kostoja është mesatare dhe e përballeshme, ndonëse kjo varet edhe nga standardi që kanë.

A keni ndonjë kliente që kërkon të duket si Ju?

- Ka pasur shumë raste kur klientet më kanë thonë t'ua bëjë vetullat si të mijat, ta kenë lëkurën si timen, por edhe raste që kërkojnë këshilla për mirëmbajtje të flokëve etj.

Keni pasion, hobi?

- Kam pasur dëshirë të bëhesha mjeke, por ja që jam bërë estetiste dhe jam e kënaqur. E, pasioni dhe hobi im është puna dhe profesioni që kam, e që më duket magjepsës.

Secili njeri ka një mision. I juaji është?

- Të japë maksimumin nga vetja në çdo gjë dhe t'i bëjë femrat të ndihen të bukura e të plotësuara në këtë aspekt.

Raporti juaj me udhëtimet, shëtitjet?

- Shëtitjet i realizoj jashtë vendit bashkë me familje, sepse në atë mënyrë gjej qetësinë e kërkuar.

Tri gjëra me rëndësi unike në jetën tënde?

- Shëndeti, familja, puna.

A beson në Zotin?

- Gjëja e parë që vjen në jetë gjatë gjithë jetës është Zoti Elhamdyrylah. Ai ma ka mundësuar t'i përkulem 5 herë në ditë. E, gjithkujt këtë mirësi nuk ia mundëson Allahu. Ramazani shqyrr që mbërriti dhe agjëroj patjetër, sepse jam gjallë falë Allahut.

Mesazhi për femrat?

- Të besojnë në vetveten, në atë që janë dhe që dinë se mund ta bëjnë. Forca e femrës është e pakrahueshme, vetëm duhet të dinë ta përdorin siç duhet, në të mirën e tyre, të familjes dhe shoqërisë në përgjithësi.

Nderim Neziri





Shqiptarët jetojnë për inati të njëri-tjetrit!

Inatet janë në modë. Politikanët bëjnë politikë për inati të njëri – tjetrit. Por, psenë nuk e di askush. Zoti e di prej nga vjen kjo! Nuk ka muhabet as bisedë që nuk dëgjon njeriu - njeriun të flasë se si ka bërë diçka keq dhe në kundërshtim të rregullave, vetëm e vetëm për ta plotësuar një inat! Mbase kjo të kujton diçka të madhe se ne, shqiptarët, kemi dëshirë që për inati të lëmë shumë interesa. Prandaj, nuk thuhet kot: “Për inati të resë, më vdektë djali!”.

INATI ME IU NËNSHTRUA MASHKULLIT!

Dy vajza ecin para meje nëpër tunelin afër “Santesë” në Prishtinë, të martën që shkoi dhe ja se ç’bisedojnë:

“Unë e doja atë, por më vinte inati me ra aq poshtë të ai. Më vinte inati me i thënë se e dua... Inati bre me qit veten aq poshtë... Pak na ka ra me ndenj bashkë, sepse ai, vjet, pas njohjes sonë, u kthye në Gjermani.

Edhe atij i kishte mbetur merak me ndenj me mua, por inati nuk e kishte lënë me m’u afrua. Thashë me vete: Nëse do me fol me mua ja ku jam. Pse me e lutur unë atë! Valla inati është me ra në qasi nivel!”.

NUK IA KTHEN PARATË PËR INATI!

Edhe kthimi i borxhit shpesh lidhet me inate. I ka borxh dikush dikujt dhe nuk ia jep, sepse ai po bën kapadaillëk

me stilin e veshjes dhe të ecurit.

Nuk e lë inati me ia kthyer borxhin dhe kërkon fesat...

Ja si shprehet një burrë:

“Fqinji im m’i ka pas dhënë pesëdhjetë euro, para tre muajsh. Por, nuk e kam ndërmend me ia dhënë hiq. Dhe, a di pse? Veç që po shitet shumë kapadai! Po ec udhës thua se e ka çliruar Prishtinën! Dhe, nuk e kam mendjen me ia dhënë veç për inati.

Kur po takohet me mua me m’i lyp paratë po i vjen inati. Sidoqoftë, kam me ia dhënë, sepse s’kam mbetur në fatin atyre parave, por nëse më thotë pse m’i ke vonuar, kam me i thënë se e kam bërë me qëllim, për inati se po shitet frajer”.

FQINJI BËN DASMË ME TUPANË PËR INATI TË MËHALLËS!

Edhe dasmat, madje, lidhen me inati.

Tupanët janë ata që për inati të fqinj

kërkohe të shqyhen dhe të pëlcasin.

Flasin dy burra:

“Po, çka t’u deshën në dasmë dy tupanë bre, sepse një boll ka qenë e po harxhon para kot?!”, i thotë njëri.

I dyti i përgjigjet:

“Pe di që është gjynah me harxhuar para kot, por veç për inati të mëhallës e kam bërë, se fqinji im në dasmën e vet i ka pasur dy tupanë.

Le ta dijë mëhalla se kush jam unë! Vetëm për inati i kam marrë dy tupanë dhe u thashë të dyve me bë hallakamë përnjëherë.

Kështu, duhet me u treguar mëhallës se kush jam, sepse fqinji im ma le mercedesin para dyerve, me qëllim që t’më nevrikos! E, edhe unë do ta bëj nervoz me tupanë!”.

Pra, ne, shqiptarët, për inati të njëri-tjetrit, jemi në gjendje ta shkatërrojmë veten, vetëm ta përbuzim tjetrin...

Jemi për librin e Ginisit, a?!

Selim Rama

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



JETË KOSOVARÇE...

*Jeta është e vetmja rrugë që nuk
udhëtohet dy herë!*

Le të shpëtojmë nga lufta se përveç bukës, kripës e ujit, të tjerat qenkan tepricë, shqiptohet atëherë refreni në vend të përshëndetjes.

U mbush toka me varre, kaloi krahura, u përmend një kohë Bllaca e kufirit dhe shumë Bllaca të tjera dhe u harruan shpejt, bashkë me bukën e kripën si fjalë e betim! Dhe, ja, 23 vjet pas lufte, po të kenë mundësi të gjithë ata që u kthyen, por edhe ata që nuk ishin kurrë jashtë vendit, duket se do të iknin nga Kosova!

Ky disponim, kjo gjendje, është argumenti më i fuqishëm se çka, si dhe sa është punuar në Kosovë pas lufte...

Pse kjo situatë, kjo gjendje e tillë?

Pse ky entuziazëm te qytetarët, posaçërisht të rinjtë për të ikur jashtë vendit?

Kë duhet ta ngacmojë kjo gjendje?

Pse Kosova u bë vend nga duhet ikur?

E dikush, në pastë kush, duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve.

Edhe diçka: mbi 50 mijë të rinj kosovarë për çdo vit i mbushin 18 vjet. Mosha mesatare e popullatës që në Kosovë është rreth 23 vjeç është lakmi për shumë shtete të botës... E ne?

*

"Sen s'po marrë vesh. Unë mujta me u kujdes për 9 fëmijë që i kam, e këta 9 s'po mujn me u kujdes sot për mue!", janë këto fjalë të plakës 77-vjeçare, Selvijes, e cila habitet me kohën çfarë ka ardhur për të ekzistuar, për të jetuar...

E habitë më shumë fakti se qysh ndodh kjo tash kur e kemi shtetin tonë...

Gani Dili

Pse po na rrahin fëmijët?

Në kuadër të ndryshimeve socio-ekonomike dhe psikologjike që po ndodhin në Kosovë, me siguri, është kuptuar edhe fakti tjetër - se duhet filluar rrahja e baballarëve tanë, e nënave, e motrave, e vëllezërve... Keq!

PSE DHE QYSH TË RRAHË FËMIJA?

S'ka ditë që policia e Kosovës nuk raporton për rrahje të baballarëve nga fëmija, të rrahjeve të nënave, të motrave, të vëllezërve...

Por, rasti i ditëve të fundit, e që bëri shumë bujë në mediet e Kosovës është ai i Varli Corleone, nga Gjilani, i cili u burgos nga policia e Kosovës shkaku i rrahjes që bëri ndaj babait të tij.

E, raste të ngjashme ka me bollëk çdo ditë në Prishtinë dhe në qytete të tjera të

Kosovës...

Po ashtu, raste të tilla ka me bollëk edhe në Shqipëri. Madje, atje gjendja në këtë aspekt është edhe më e rëndë dhe e çuditshme.

KËTU E KAM PAS LËNË BABANË TIM DIKUR!

Prandaj, zor të jesh baba, a? E për të qenë nënë, dihet, është edhe më zor. Ata që vrasin apo rrahin babanë, duhet të dinë se çka thotë populli: "Krejt i gjen pos babë e nënë!".

\Por, kjo thënie ka ndryshuar kohëve të fundit. Nënë nuk mund të gjesh, por baba gjen po ta kesh nënën e bukur. Bile, e gjen edhe më të mirë se që e ke apo e ke pasur!

Por, adeti ynë nuk ka qenë t'i rrahim prindërit, as t'i vrasim.

Dhe, për ata që i rrahin prindërit, por edhe për ata që ende nuk kanë filluar t'i rrahin, vlen të tregohet një urti popullore:

Një djalë e kishte futur babanë në thes për ta humbur. Me thesin në shpinë nisjet drejt malit. Gjatë rrugës lodhet dhe vendos ta lëshojë thesin. Babai, e që ndodhej në thes, i thotë të birit:

"Më qo më larg, sepse këtu e kam pas lënë unë babanë tim!".

Djali ndalet. Dhe, pasi e mendon mirë e mirë këtë punë, thotë me vete: "Më mirë

po e kthej në shtëpi, sepse edhe im bir dikur do më hedhë diku".

A JEMI ÇMENDUR NE, SHQIPTARËT?

Shtrohen pyetjet: A jemi çmendur ne, shqiptarët? Çka po ndodhë me ne? Sidoqoftë, a e dini si e sqaron religjioni këtë marifet?

Asnjë fëmijë nuk mund ta vret babanë po qe se ai realisht është babai i vërtetë i tij. Religjioni thotë se "harami del në shesh!". Nëna është fajtorja e vetme, sepse ajo e di me kë e ka fëmijën. Demek, me cilin burrë e ka atë fëmijë, sepse fëmija i vërtetë nuk mund ta vrasë babanë e vet e as ta rrahë. Prandaj, po ndodhin ndryshime tepër të mëdha sa nuk jemi kah e njohim as veten në pasqyrë. Jemi bërë si kryetari i komunës së Podujevës, para 60 vjetësh, kur ishte zgjedhur "presednik" komune...

Një burrë ishte zgjedhur kryetar i komunës së Podujevës në kohën e komunizmit. Pjesa më e madhe e flokëve i kishin rënë. I kishin thënë që, edhe pse kishte pak flokë, të kishte me vete në xhep krehrin e pasqyrës. Një ditë ai nxjerr pasqyrën prej xhepi, shikohet në të dhe me krehrin u bie atyre pak flokëve që kishte. Pastaj, e shikon gjatë veten në pasqyrë dhe thotë: "Heu bal, heu... Bytha jote "presednik"!"

Selim Rama



Pastruesja shqiptare “Miss USA”

*Marinela Shpati
është shqiptarja
që fitoi titullin
“Miss Michigan
America 2022”.*

Pas zgjedhjes mis ajo ka rrëfyer gjithë jetën e saj, që nga vështirësitë në Lezhë, emigrimi në Greqi deri te jetesa aktuale në Amerikë.

Sakaq, Marinela ka zbuluar edhe emocionet e fitores së çmimit të parë, madje edhe mbështetjen e pakushtëzuar të bashkëshortit.

“Jam e lindur në Lezhë. Jam rritur në një fshat, në Troshan. Kam jetuar 10 vjet në Shqipëri, pastaj kam shkuar me familje në Greqi.

Në Greqi jeta ka qenë më e mirë se në Shqipëri, kam filluar punë që 14 vjeçe dhe paralelisht shkoja në shkollë.

Punoja në një restorant, bëja gjithçka nga shitëse në pastruese, çdo gjë.

Në moshën 20-vjeçare kam shkuar në Amerikë, kam ardhur me vetëm një çantë me rroba. Kam punuar deri në 4 punë, derisa kam arritur këtu ku jam, që punoj në bankë.

E kam burrin e mirë, është nga Shkodra, kam 3 vjet e martuar.

Të gjithë femrat që konkurrojnë kanë një platformë dhe unë kam një për të ndihmuar njerëzit e varfër. Në mënyrë që ata kur t’më shohin të thonë si ka mundësi që kjo ka arritur deri këtu se para 20 vitesh ishte e varfër, punonte pastruese.

Jam shumë e lumtur. Kam arritur një eksperiencë të bukur”, thotë ajo.





Bizneset në Gjermani me peshë për zhvillimin e Kosovës

*Anëtari i kryesisë
Bekim Borovci i
shoqëruar nga Faton
Blakqori, përfaqë-
sues të UNION-it u
mirëpritën nga Am-
basadori i Repub-
likës së Kosovës në
Berlin, z. Faruk Ajeti.*

Temat e bisedimeve gjatë takimit ishin ekonomia e Kosovës dhe ndërtimi i lidhjeve të vazhdueshme me tregun gjerman. Ambasadori z. Ajeti falenderoi kontributin e bizneseve shqiptare në Gjermani në fushën e investimeve në Kosovë, të cilat kontribuojnë në ngritjen e zhvillimit të ekonomisë, promovimit dhe plasimit të produkteve dhe shërbimeve

nga Kosova në Gjermani. Bekim Borovci përcjelli nga UNION-i respektet e Kryetarit, Nazmi Viqa, faleminderimet për iniciativën nga Ambasadori për kontaktin dhe shtjellimet e temave ekonomike të përbashkëta me bizneset në Gjermani me peshë të veçantë për zhvillimin e Kosovës.



Mos pastë kush martesë të zezë si unë!

Të ma kishin zgjedhur vetë prindërit Xhevdetin, të dashurin, të fejuarin dhe përfundimisht burrin tim, do të hasmërohesha shumë në ta! Por, e zgjodha vetë...

E keqja është se prindërit nuk ma gjetën Xhevdetin, por e gjeta vetë! Por, kur e di se unë vetë isha përcaktuar për një fat të tillë, duhej me, patjetër, t'i përballoja të gjitha: edhe jetën, edhe mundin, edhe fyerjen, edhe ngujimin në shtëpi, edhe injorimin, madje edhe kthimin e shpinës në dhomën e gjumit, vetëm e vetëm që të ikja nga ajo shtëpi e mallkuar.

Kisha duruar gjithë të zezat në emër të dashurisë sime të jashtëzakonshme për të, mirëpo kisha gabuar pikërisht rëndë mu këtu, sepse sytë e mi i kishte verbuar me kohë dashuria për të.

Dhe, duke menduar se me zgjedhjen e fatit të dashurisë, e më pas me kurorëzimin tim do zgjedhja njëherë e përgjithmonë problemin tim jetësor, sakaq isha e dën timer që vuajtjet e mia të shtoheshin dhe të mos kishin fund.

Mirëpo, të shkruarën e jetës sime nuk mund ta ndryshonte dot askush...

SHKOLLA E MESME NUK MË SHKOI BASH KURRQYSH!

Me zor vijoja tutje. Por, nuk isha njëra nga ato të shquarat për probleme e njolla të zeza. E ndjeja veten të qetë dhe, kuptohet, të lumtur që e kisha ndërgjegjen e pastër.

Në familje kisha aq mbështetje sa të përballoja gjithë kraijat e jetës dhe, natyrisht, të ballafaqohesha me të papritura nga më të ndryshmet.

Por, në fakultet gjërat ndryshuan. Isha e dhënë së tepërmi pas provimeve që i jepja sa mbyllë e hapë sytë...

Dhe, ç'është e vërteta, kjo më bënte që të ecja ballëlartë.

Por, kuptohet, nuk e teproja, nuk kthehesha në orët e vona të natës, ani pse autobusi për në fshatin tonë qarkullonte deri në orën 20.

Nuk pranoja në asnjë mënyrë që rreth e

rrotull meje të ziheshin fjalë të pavërteta, të cilat do të pamundësonin lirinë time, e të cilën e kisha gëzuar deri atëherë.

E, kjo më nxiste të kisha kujdes me sjelljet dhe veprimet e mia...

MOTËR, VEÇ MOS NA KORIT!

"Motër, ne do të krijojmë kushte për studimet tua me kusht që ti të mos na koritësh dhe të mos na sjellësh probleme në shtëpi. Prandaj, nëse ta merr mendja të shkosh në fakultet, ne nuk të pengojmë asnjë fije, e nëse nuk e ke mendjen te fakulteti tregona më mirë me kohë", më tha më i madhi vëlla në ditën kur i fillova studimet, më 1 tetor.

Pse më tha ai kështu?

Sepse, im vëlla, Rrahimi, aso kohe e kishte "timonin" e shtëpisë në dorë, meqë babai kishte kohë që ishte jo mirë me shëndet, kurse vëllezërit e tjerë ishin më të ri se ai.

Dhe, që nga ditët e para të fillimit të studimeve, i kisha thënë vetes se duhej të arrija një sukses të mirë, që provimet t'i jepja me kohë dhe fakultetin ta kryeja brenda afatit të studimeve...

Por, qëllim tjetër kisha që me kohë të gjeja edhe fatin e jetës dhe të mos prisja nga familja të më martonin, sepse kushërirat e mia ishin martuar me mesitni dhe asnjëra nuk ishte e kënaqur me jetën e tyre bashkëshortore.

Thënë të drejtën, nuk u lakmoja atyre shoqeve të mia që në ditët e para të fakultetit u dhanë pas të dashurve të tyre dhe provimet e tyre i mbuloi pluhuri i harresës...

Andaj, vendosa që të duroja gjithë uraganin e vardisjeve të studentëve që ishin në vitet më të larta në fakultet, e që e hidhnin grepin në brucoshet bukurorshë të fakultetit tonë. Dhe, ashtu, më priu e mbara, sepse kurrë një fjalë të ligë vëllezërit e mi, në radhë të parë, por as rrethi më i gjerë familjar nuk e dëgjuan për mua, sepse e kisha përmbajtur me mund të madh veten që të mos devijoj a të fundosesh si pa krye në ndonjë "dërrasë të kalbur" dhe, pastaj, vajhalli për mua...

NJOHJA ME LLAPJANIN MA NDRYSHOI JETËN

Duke i dhënë të gjitha provimet semestrale në janar e prill dhe në afatin e qershorit, e që ishte rast i rrallë, ishin përsëri vëllezërit e mi që më inkurajuan, duke më shpërblyer gjatë muajit gusht me një javë pushim në det, në Shëngjin.

Isha e lumtur, sepse për herë të parë e shihja detin, Shëngjinin, bashkë me vëllanë e madh dhe nusen e tij.

I buzëqeshja vetes dhe më dukej sikur diku afër meje është edhe fati im i jetës...

Në të vërtetë, derisa isha duke u larë me nusen e vëllait, afër nesh laheshin edhe dy të rinj, njëri prej të cilëve nuk m'i largonte sytë dot... Në një moment ai gjeti rastin dhe m'u afrua aq afër, sa edhe ma preku dorën, duke më thënë se ishte nga Podujeva, student i Fakultetit Juridik në Prishtinë.

Dhe, që nga ajo ditë, thënë të drejtën, jeta ime mori kah tjetër... shumë e shumë net i kalova duke menduar pamjen e fytyrës së tij, momentin kur ma preku dorën teksa laheshim në det, por edhe fjalët se do më gjej në Prishtinë, dosido...

E, kur erdhi tetori, fillimi i ligjëratave, unë isha e pranishme në sallat e mësimi fizikisht, por mendja më fluturonte gjithkrah. I mendoja dhe i bluaja në kokën time ato pak fjalë të "studentit" nga Podujeva dhe prisja çdo ditë ta hasja në korridoret e gjata të fakultetit tim...

Por, edhe kur kthehesha në shtëpi tretesha në mendime, përhumbesha, shfletoja faqe të tëra të librit në duar pa kuptuar gjë dhe, kuptohet, gjithë ky ndryshim imi nuk mund të mos vërehej edhe në shtëpi, por edhe nga shoqet e mia të fakultetit.

PA PËLQIMIN E FAMILJES U BËRA NUSE!

Jeta ime në një anë, e posaçërisht dashuria ime, mori kthesa të papara-shikueshme: në nëntor të atij viti në hyrje të derës kryesore të fakultetit tim u paraqit ai, djaloshi nga plazhi i Shëngjinit, studenti llapjan... Më tha se kishte qenë tre muaj në Zvicër të vëllezërit e vet dhe nuk kishte si t'më lajmëronte, meqë nuk patëm kur t'i këmbënim numrat e telefonit.

Dhe, në vend që të fillonim të dilnim bashkë, ai po atë ditë, teksa pinim edhe kafënë e parë bashkë në byfenë e fakultetit tim, më propozoi fejesë...

Në vend të përgjigjes unë vetëm i buzëqesha dhe asgjë më shumë... Por, në pranverën që erdhi, pas dimrit të gjatë, unë u fejova me të dhe gjatë verës planifikonim të martoheshim, ani pse dikur mendoja se pa e kryer fakultetin s'kishte as fejesë e as martesë...

Mirëpo, nuk mund të llogarisja më në vete, meqë te unë veç kishte humbur ai vullnet i dikurshëm për studime, kështu që nuk kisha rrugëdalje tjetër veç fejesës e pastaj edhe martesës...

U dhashë "fund" studimeve në afatin e qershorit pa dhënë, madje, asnjë provim të vetëm dhe pa i treguar kujt nga familja për "dhëndrin" e tyre të ardhshëm.

Dhe, pas një fejeje të shpejt, në shtator të atij viti edhe u bëra nuse. Por, nuse pa pëlqimin e vëllezërve të mi, të cilit ishin kundër martesës sime pa e kryer fakultetin. Andaj, më erdhi keq nga vëllezërit e mi, e të cilët nuk kursenin gjë që ta kryeja fakultetin, dosido... Pra, pa pëlqimin e familjes sime unë vendosa të bëhesha nuse e llapjanit, për të cilin mendoja se ishte tamam tip imi, tip imi ideal... dhe se familja e tij, siç më thoshte ai, i përshtatej shumë familjes sime, e që për mua s'kishte ku të shkonte më mirë...

SI NISI TË ERRËSOHEJ BOTA E ËNDRRAVE TË MIA?

Mirëpo, pas javëve të para si nuse filloi të errësohej bota e ëndrrave të mia, meqë burrin tim e sundonin krejtësisht nëna dhe motrat e tij, të cilat mua ma kishin inati, kushedi për çka, edhe pse

kurrë nuk ndalesha së punuari: fshija e laja, madje edhe gatuaja...

Por, nuk mund t'i përthekeja të gjitha, sidomos kur pas tetë muajsh martesë barku im gjithnjë e më shumë fryhej...

Por, barku im, edhe pse çdo ditë dukej haptazi se fryhej, nuk i pengonte askujt në atë shtëpi që unë të pastroja e laja, të gatuaja e të punoja edhe në bahçe.

E, im burrë, nuk guxonte të nxirrte fjalë nga goja nga nëna e motrat e tij, së paku t'u thoshte që t'më ndihmon sado pak në punët e shtëpisë...

Ndërkaq, unë heshtja, sepse si femër e edukuar në frymën patriarkale në familje, duhej të mos bëzëja dhe të mos ua ktheja fjalën në shtëpinë e burrit.

Dhe, nisur nga ky shkak, shpesh mbyllesha në dhomën time dhe qaja, derisa edhe lodhesha së qari. E, kur ndodhte të hynte im burrë në dhomën tonë të gjumit dhe më gjente duke qarë, në vend se t'më ngushëllonte a të m'i fshinte lotët, ai shpejt e shpejt ikte nga dhoma dhe tretej, siç thuhet në popull, "si shurra pas shiut!".

E dija se ishte djalë hasreti dhe mundohesha ta kuptoja qëndrimin e tij, por a kishte të drejtë të sillje me mua ashtu?

VONË U MBUSH MEND BURRI IM!

Në kohën kur fjalosesh me burrin kurdo që më jepej rasti, i cili aspak nuk kishte mëshirë për mua, më lindi edhe fëmija i parë, vajzë. Atëherë thash: "Tash do ndryshoj gjithçka!".

Por, shpifjet në atë shtëpi të mallkuar nuk pushonin – vetëm babanë e tij e kisha në anën time, të tjerët rrallëherë më flisnin dhe atëherë, kryesisht, kur kishim mysafirë.

Për gjendjen time në atë shtëpi nuk guxoja t'u tregoja vëllezërve, sepse babait s'kisha çka t'i tregoja meqë ishte i sëmurë, kurse nëna kishte vite e vite që më kishte vdekur. Dhe, kisha vendosur të vuaja vetëm e vetëm që të mos i lëndoja të shtëpisë sime, të cilët me kohë nuk qenë të pajtimit që të bëhesha nuse në atë shtëpi...

Andaj, durova e durova rrafsh katër vjet, kur më lindi edhe vajza e dytë, duke shpresuar se dalëngadalë po lëshoja "rrënjë" në atë shtëpi...

Por, fati deshi dhe burri im sikur u mbush mend dhe dalëngadalë filloi të mos i dëgjojë e as respektojë urdhrat e nënës së tij, por as të motrave.

E, tek kur vajza e dytë u rritë që të shkojë në shkollë, vdiq vjehrra, kurse motrat e burrit tim një nga një u martuan, kurse mua zullumi prej tyre m'u hoq njëherë e përgjithmonë...

M. Ajeti



Disa burrave u shkon jeta t'u rrejt!

Femrat rrejnë, sepse nuk duan ta lëndojnë partnerin. Ndërkaq, prapa rrenave të meshkujve më së shpeshti fshihet një ego e fortë. Sipas psikologëve, meshkujt rrejnë më shumë se femrat...

FEMRAT I MUNDON NDJENJA E FAJIT

Meshkujt, duke qenë robër të egos, zmadhojnë suksesin në punë në mënyrë që ta bëjnë femrën për vete. Edhe pse 75 për qind e meshkujve dhe femrave mendojnë se disa rrena janë të arsyetuara, sepse parandalojnë grindjet, ndjenja e fajit më shumë i mundon femrat. Edhe ekspertët pajtohen se rrenat e vogla

mund të jenë të mira. Ata thonë se edhe ato, nëse bëhen shprehi, mund ta rrezikojnë lidhjen. Meshkujt më së shumti rrejnë rreth asaj se sa kanë pirë, kurse femrat rrejnë më së shpeshti për ta fshehur zemërimin, p. sh., për shkak të ditëlindjes së harruar.

RRENAT E MESHKUJVE

- * Kam pasur shumë femra;
- * Nuk kam pirë shumë;

- * Nuk kisha qasje në celular;
- * Nuk dukesh e trashë, aspak;
- * Në punë çdo gjë është ok!

RRENAT MË TË SHPESHTA TË FEMRAVE

- * Çdo gjë është në rregull;
- * Nuk kushtoi shtrenjtë;
- * Edhe pesë minuta jam gati;
- * Më dhemb koka.

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
**Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.**

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

O burrë, a po vjen nga Zvicra a e gjeta tjetrin?!

Teksa dëgjon histori të tilla, të duken të pabesueshme. Por, në fakt, ky është realiteti për një pjesë të konsiderueshme të grave që "braktisen" nga burrat që zgjedhin kurbetin, ndoshta, për një jetë më të mirë, apo...

"Im burrë ka dy vjet që nuk ka ardhur në Kosovë dhe unë nuk mund të duroja më... Një ditë, teksa rrija në ballkonin e shtëpisë sime, një djalë, rreth të 30-ave, rrinte ulur në një karrige në lokalin para shtëpisë sime dhe më vështronte, ashtu si nuk më ka vështruar asnjëherë as burri im... Më shikonte si i çmendur...

PSE NISA TA PROVOKOJ?

Dhe, pa e zgjatur shumë fillova ta provokoj. Zbulova kofshët e mia, duke

bërë sikur po bëja punë në ballkon... Ai më shikonte pa m'i ndarë sytë. Dhe, pa hezituar i bëra shenjë të vinte. Ai u afrua te dera e shtëpisë sime, e unë, pa u menduar aspak, ia hapa derën e ai u fut brenda. Shpejt e shpejt e mbylla derën dhe e futa në dhomën time të fjetjes, meqë fëmijët nuk ishin në shtëpi për momentin.

MË DOLI FLAKA ATY PËR ATY!

Filluam të putheshim pa hezitim. Dhe,

nuk durova dot e u hodhëm në shtrat, sepse unë kishte dy vjet pa bërë seks. Pastaj, u ngrit dhe i thashë që kjo qe hera e parë dhe e fundit... Sepse, e dija se po ta zgjatnim punën do të zbulohesha nga fëmijët, familja dhe farefisi e do mbetja, pastaj, me gishta në gojë...

Por, s'di si do të ndihem kur t'më kthehet burri nga kurbeti?!

Dhe, të vjetrit nuk kanë thënë kot: Punoje tokën tënde nëse nuk dëshiron ta punojë tjetri!

Fikrija, Gjilan

Modele: Kujtesa Gashi-Tesa

BOOM

**Ku janë zhdukur
këngëtarët tanë?**

Si u duken
në ditën e martesës
Shkurtja, Shyhretja, Gili,
Remzia e Ganimetja?

**Big Mama
tregon vuajtjen
para dhe pas
operacionit**

Kujtesa Gashi -Tesa
estetistja akademike
në Kosovë e Shqipëri

A portrait of Kujtesa Gashi-Tesa, a woman with long, dark, wavy hair and bangs, wearing a white blouse with a large bow at the neck and a red skirt. She is looking directly at the camera with a slight smile. Her hands are crossed in front of her.

Kujtesa Gashi -Tesa,

estetistja akademike në Kosovë e Shqipëri



Kujtesa Gashi, e njohur si Tesa, është profesionistja brilante e fushës së bukurisë, me përvojë të gjatë dhe të pakrahasueshme si make-up artiste dhe estetiste ndër më të njohurat shqiptare.

Tesa ndër vite e ka zgjeruar gamen e shërbimeve që ofron dhe gjithmonë duke mbetur e jashtëzakonshme në çdo punë që bën.

“Tesa Academy” në Tiranë e Prizren është perandori e bukurisë, ku trajnohen e certifikohen shumë studente. Tesa është trajnere ndërkombëtare nga “Purebeau” gjermane, nga “Intrigo” italiane dhe tash, së fundi, nga “Archelle” franceze, me seli në Turqi për Ballkan.

Për Kujtesa Gashin, CV-në profesionale, akademitë e saj dhe risitë që po vijnë, lexoni në “Boom”...

HISTORIA E GRUAS QË U BË IKONË E BUKURISË DHE ESTETIKËS

Për Tesen gjithçka filloi në moshë të re, kur ajo ishte në klasën e shtatë të shkollës fillore, kur nisi të merrte zanatin të mjeshtri i madh, Shefki Xharavina, grimer dhe parukier i artistëve.

Tutje, si 19-vjeçare, hapi sallonin më modern në Kosovë, ku përfshiheshin të gjitha shërbimet e bukurisë, parukerisë, estetikës, pastaj sauna, solare, etj.

Tesa është e para që nisi të punojë me produkte prestigjioze për grim, si ato “Ester Lauder”, “Lancom”, “Cover”, “Wella”, “Maybeline”, “Loreal”, e shumë të tjera.

Duke qenë person që nuk rresht së kërkuari më të mirën dhe nuk ndalet në rrugën e avancimit profesional, Kujtesa Gashi-Tesa mbaroi me sukses Universitetin e Kozmetikologjisë në Maqedoni, e më pas në Gjermani, në Akademinë më të madhe gjermane “Purebeau”, ku edhe u emërua trajnere ndërkombëtare për P. M. U. Artist:

- * Nedling
- * Mesoterapi
- * Removal tato
- * Areola
- * M. H. S, e të tjera.

Tesa, e licencuar në një nga akademitë më prestigjioze evropiane, në vitin 2014, nga “Purebeau” u zgjedh tranerja më e mirë në Ballkan.

E, kur nisi aplikimi i Microblading, si gjithmonë, u bë e para që këtë metodë e solli në Kosovë e Shqipëri dhe mësoi me qindra nxënës për ta aplikuar, që sot janë tejet të suksesshme në këtë fushë.

Tesa njihet edhe për punën e shkëlqyer në zgjatjen e qerpikëve, të njohur si “Extesion Lashes”, për çka është aftësuar, profesionalizuar dhe pajisur me licencë për trajnime nga Akademia e famshme “VIV” në Greqi, duke u emëruar si trajnere e “VIV” për Kosovë dhe Shqipëri dhe “Liwuxus lashes” në Vjenë. Gjithashtu, merr të drejtën nga Akademia ndërkombëtare “Micro-medico”, si trajnere për “Magic Cristal”, që bën heqjen e rrudhave me ajër. Ajo, po ashtu, është trajnere e “Dernals”, ku është trajnuar nga mjeku indian, i katërti më i miri në botë, Rajat Bhandari.

Trajnime, aftësime profesionale, certifikime, Tesa ka në shumë profile të estetikës nga akademitë estetike më të famshme në botë, përfshirë këtu edhe “Beauty professional Akademi Hyllaronica” me seli në Francë, ku iu dha e drejta për injektim të dermal fillerit.

Është trajnere ndërkombëtare edhe e akademisë italiane “Intrigo”. Së fundi solli edhe një “boom” në fushën e estetikës, metodën me fije kolagjeni nga Franca, ku u emërua nga “Archelle” master për fije kolagjeni, e që tutje trajnon kursante për aplikimin e metodës më të re dhe më inovative në botë.

Pra, Tesa nuk ndalet asnjëherë, duke gjetur gjithmonë motiv për të vazhduar më tej dhe më bindshëm e më fuqishëm në rrugën e avancimit dhe sjelljen e risive nga fusha e bukurisë dhe estetikës në botën shqiptare. Thotë se do të jetë e tillë gjithmonë, meqë puna për të është jetë, dashuri, pasion.



“TESA ACADEMY” SJELL NË SHQIPËRI E KOSOVË PROFESIONISTET ME FAMË BOTËRORE KÛBRA KEHRIBAR DHE SULLTAN BEKAR

Në muajin maj, Akademia “Tesa Purebeau Academy”, me seli në Tiranë dhe Prizren, mban seminarin e madh, të parin pa pagesë, me të ftuaren speciale Kûbra Kehribar, që është një nga emrat kryesorë në këtë sektor, me përvojën e saj 20-vjeçare, si dhe trajneren internacionale Sulltan Bekar, të cilat do të sjellin përvojat e tyre të jashtëzakonshme përgjatë shumë viteve në këtë fushë.

Nderim Neziri

A i mbulon pluhuri i harresës...

Sa herë që flitet për muzikën, argumenti kryesor është nëse një këngëtar a këngëtare e meriton apo jo famën e marrë.

Gjatë evolucionit të muzikës kemi parë shumë këngëtarë të vijnë dhe të ikin. Disa prej tyre jo vetëm që kanë lënë emrin e tyre, por kanë dhënë një ndikim afatgjatë. Këngëtarë nga të gjitha zhanret, “rock” apo “pop”, na e ndryshuan jetën me artin e tyre, duke nga shoqëruar në momentet më të gëzuara apo të trishtuara. Sjellim në mend disa nga emrat që i mungojnë muzikës shqiptare, për vlerat e tyre vokale dhe për hir të hiteve që kanë bërë vite më parë...



ALKETA VEJSIU

Është një personazh që nuk i është larguar ekranit shqiptar për asnjë moment, por i ka munguar skenës së muzikës.

Alketa nisi të këndonte që në moshën e adoleshencës, por vendosi që të kishte prioritet gjithmonë moderimin e spektakleve të njohura. Kënga e fundit me të cilën u prezantua është “Po s’më puthe ti”, e vitit 2004.

Dhe, pavarësisht se herë pas herë performon këngë të famshme, nuk ka ardhur me hit të saj.

Ku janë zhdukur këngëtarët tanë?



JULKA GRAMO

Tashmë ka kaluar në statusin e moderatores, atë të nënës së dy djemve dhe të bashkëshortes së DJ Andit.

Ndërsa prezanton një emision në “NRG Radio”, Julka është shkëputur nga muzika që në vitin 2014, pas publikimit të këngës “Mëngjesi pa ty”.



ORINDA HUTA

Orinda depërtoi në tregun artistik në fillim të viteve 2000, por prej kohësh nuk ka sjellë më asnjë hit të ri.

Në vitin 2014 prezantoi dy këngë të suksesshme: “Boom Boom” dhe “Te amo”. Huta i është fokusuar karrierës si moderatore.



MALDA SUSURI

Kanë kaluar vite qëkur këngëtarja Malda Susuri preku zemrat e të gjithë të dashuruarve me hitin "Dashuri e hidhur". Kënga u pëlqye dhe u memorizua aq shumë nga publiku, saqë të gjithë e njohin edhe sot.

Malda, së fundi, u kthye me një album, por pa zhurmën dhe impaktin e dikurshëm.



TUNA

Gjithmonë e pëlqyer dhe energjike, por viteve të fundit më e heshtur, për shkak të angazhimeve familjare.

Këngëtarja e shumë hiteve po i dedikohet më tepër jetës së saj private sesa anës profesionale, që në këtë rast është muzika.



GRUPI "AURORA"

Grupi "Aurora" u formua në vitin 2002, me iniciativën e 4 të rinjve: Nazmi Sfishtës, Alban Mehmetit, Yll Vallës dhe Yll Zajmit.

Nisën me këngën "Ëndrra e lotit". Morën famë me hitin "Le-le kaçurrele", me të cilin morën pjesë në vitin 2005 në festivalin "Kënga Magjike".


Në dhjetor të vitit 2014 "Aurora" mori pjesë në Festivalin 53 në RTSH, me këngën "Maria".



LEDINA ÇELO

Ledina Çelo i ka munguar prej vitesh skenës. Kujtojmë se ishte modera-tore në Festivalin e Këngës së RTSH-së.

"Do të heq dorë nga muzika kur mos të marr frymë. Kam lindur me muzikën. Babai ka qenë këngëtar, ne dëgjonim gjithmonë muzikë klasike. Do t'i kthehem shumë shpjet skenës, pasi është shtëpia ime e dytë", tha Ledina Çelo gjatë një interviste. Kënga e saj e fundit është "Gaboja", e publikuar më 2013.



ANJEZA SHAHINI

Ishte përfaqësuesja e parë e Shqipërisë në "Eurovizion", në vitin 2004. Karriera e Anjeza Shahinit në muzikë nisi me konkursin "Ethet e së premtës mbrëma" për t'u ndalur më 2014 me këngën "Energji".

"Boom"

Si u duken në ditën e martesës Shkurtja, Shyhretja, Gili, Remzia e Ganimetja?

Këngëtares më të dashura për publikun shqiptar: Shkurte Fejza, Shyhrete Behluli, Gili, Remzie Osmani dhe Ganimete Jashanica kanë vite të tëra që janë pjesë e skenës muzikore.

Bilbilesat e muzikës popullore gjithmonë kanë qenë simpatike dhe me paraqitjet e tyre kanë rrëmbyer vëmendje.

Përveç anës artistike, këngëtares e estradës kanë arritur të ruajnë stabilitetin në martesat e tyre shumëvjeçare dhe tashmë gëzojnë jetë të lumtur bashkëshortore.



SHKURTE FEJZA

Këngëtarja e mirënjohur, Shkurte Fejza, që 35 vjet është e martuar me Hajrush Behlulin dhe dashurinë e tyre rrallë kush mund ta ketë.

Këngëtarja disa herë ka treguar se lidhjen e saj me Hajrushin e kishte filluar që nga viti i tretë i gjimnazit.

Nga kjo martesë shumëvjeçare ata kanë katër fëmijë: Arbrin, Gresën, Besianën dhe Agnesën.

Ju sjellim një fotografi nga ditët e nusërisë së Shkurtes...



SHYHRETE BEHLULI

Bilbilesha e muzikës popullore, Shyhrete Behluli, që 38 vjet është e martuar me Lulin. Shyhretja në shumë intervista ka treguar se karrierën e kishte nisur si 16-vjeçare dhe, meqë gjithmonë kishte kënduar këngë patriotike, populli kishte menduar se e kishin vrarë në protestat e vitit 1981.

Pikërisht, në këtë vit ajo ishte martuar, në muajin gusht. Shumë njerëz kishin shkuar ta shihnin tek shtëpia e bashkëshortit të saj për të vërtetuar nëse nusja është ajo, meqë kishin qarkulluar informacione se Shyhretja nuk jeton më.

Nga martesë shumëvjeçare, Shyhretja dhe Luli kanë tri vajza dhe një djalë.



GILI

Gili dhe Ilir Berani fillimisht ishin shokë banke, e pastaj u bënë edhe shokë jete. Ata janë martuar në vitin 1990 (qe 29 vjet) dhe janë prindër të dy djemve: Robertit dhe Redonit.

REMZIE OSMANI

Këngëtarja e mirënjohur, Remzie Osmani, është martuar me Halilin në vitin 1992, pra para 27 vjetësh.

Çifti i njohur i kanë dy fëmijë: Hamzën dhe Riolën.



GANIMETE JASHANICA

Një ndër këngëtares më të dashura për publikun shqiptar, Ganimete Jashanica, ka 33-vjet që është e martuar me Ismet Jashanicën. Ata kanë dy fëmijë.

Big Mama

tregon vuajtjen para dhe pas operacionit



Pesha e ka bërë të veçantë, qysh në fillimet e saj dhe tashmë këtë të gjithë e pranojnë.

“Ajo (pesha) për mua ka qenë sukses. Sot, mund të jesh star shumë kollaj. Mund të vishesh apo të zhvishesh, është mënyra më e lehtë për të depërtuar, por mua më pranuan ashtu siç isha, ndaj edhe sot jam shumë falënderuese”, thotë Big Mama.

Por, natyrisht, pesha për këngëtaresh e njohur ka pasur kostot e veta. Besiana Kasami kreu një operacion në Turqi për rënie nga pesha. Madje, në programin e saj ajo edhe demonstroi se si do të kryhej ndërhyrja për të zvogëluar stomakun dhe për të larguar dhjamin e tepërt që kishte zaptuar çdo organ të trupit.

Peshën e tepërt qysh si fëmijë kishte nisur ta merrte nga gjyshja, e cila, si të gjitha gjyshet, e ndiqte nga pas që të hante me zor. Qysh atëherë filloi t'i pëlqejnë shumë ushqimet dhe gjithçka që hante i kthehej në peshë.

“Unë kam bërë zvogëlimin e stomakut, by pass. Tani kanali i ushqimit është i lidhur me zorrën e hollë. Kjo është një metodë efektive që

e bën ushqimin të dalë jashtë e të mos rrijë në stomak”, tregon Big Mama për operacionin në Turqi.

Muajt e parë ishin katastrofë. Ishte vështirë të mësohej me trupin e ri dhe me regjimin. Çdo ditë e merrte mjekun në telefon dhe e “kërcëronte” se do ta denonconte.

Por, shpejt e mori veten dhe sot ndihet shumë e lumtur.

“Tani ha shpesh e nga pak. Në çantë kam gjithmonë fruta. Jam shumë e lumtur që nuk po lakmoj”, tregon më tej Big Mama.

Ka vuajtur nga dietat, sa nuk do t'i kujtojë.

“Kam lënë 500 euro për dy javë, nuk isha e ngopur, nuk isha e lumtur, lija 20 kg, merrja 50. Tani them se edhe nëse nuk do të kisha mundësi, do të merrja kredi për ta bërë këtë”, thotë ajo.

Kurrë nuk kishte vuajtur nga komplekset, veten e donte siç ishte dhe vetëbesimi nuk i mungonte, por profesioni dhe puna ia imponoi këtë zgjedhje, pas së cilës u kthye në një njeri tjetër, por me po të njëjtën energji. Këto, në fakt, nuk mund të tkurren me asnjë lloj operacioni.

Turquoise M A R I N A



Hamallaj, Gjiri i Lalëzit, Durrës



+ 3 5 5 6 8 2 0 9 4 7 3 4

+ 3 5 5 6 8 6 0 2 0 3 1 5

+ 3 5 5 6 8 9 0 7 1 5 2 5



marketing@agikons.com

Dikur kishim ideale...

Ikni burra, po vjen kiameti!

*Më nuk jemi kah e njohim veten, sepse jemi tjetërsuar
aq shumë sa vetëm paranë e njohim...*

E, ç'është paraja? Nuk është vetëm monedhë materiale, por diç edhe më shumë... Sepse, shtetet e zhvilluara, e që kanë para shumë, që kanë kapital, kur duan ta shkatërrojnë një vend tjetër i japin para opozitës dhe e forcojnë atë. E, opozita, pastaj, nis ta prish shtetin...

ISHALLA S'I JEP KUSH PARA GRUAS SIME!

Megjithatë, ka edhe më keq! Muzullah me i dhënë ndokush para gruas tënde apo ndonjë anëtar tjetër të shtëpisë, ta prishin shtëpinë, ta shkatërrojnë familjen. E, shteti dhe familja i ngjajnë shumë njëra-tjetrës.

E dini si u shkatërruan shtetet arabe? E shkatërruan Libinë, pastaj e vranë Gadafin. Pastaj, i hynë Irakut dhe e zunë Saddam Hyseinin, të cilin e ekzekutuan bashkë me disa bashkëpunëtorë të tij.

Më pas i hynë Egjiptit e Sirisë, kurse tash ua kanë mësyre Katarit e Arabisë Saudite... Krejt këto ndodhin, sepse dikush jep para dhe krijohet interesi mes palëve në konflikt. Paraja kudo që hyn e ndryshon gjendjen, pamjen. E, kjo po dëshmohet dita-ditës.

Sepse, dikur kishim ideale, e tash ideal e kemi paranë!

SHIJA E FUNDIT E BOTËS

Janë do shenja që në libra të shenjtë flasin për gjendje apokaliptike të botës. Nuk është e vështirë ta definosh këtë kohë. Sot jemi në kllapat e kësaj kohe të paralajmëruar nga profeti që solli Kuranin, e njëri ndër këto probleme të paralajmëruara është abuzimi moral dhe amoralitetet e botës animale.

Por, e keqja është edhe më e madhe kur njeriu sheh se çfarë servohet në rrjetet e internetit dhe, madje, në vetë portalet që i lexojmë ne dhe fëmijët tanë.

Një ditë, në një portal tonin, ndodhej një shkrim ku tregohej se seksi me kafshë ishte pasojë e fëmijërisë. Tash ec e kuptoj se çfarë përkufizimi ka dashur të thotë ai që e ka dhënë shkrimin, por me gjasë dihet se çfarë ka menduar ai...

Po, pse ky shkrim?

A pak femra ka sot, a?

Kush është ngushtë për kafshët?

Tmerr! Por, që tmerrin të jetë edhe më i madh, ky shkrim i tregon brezit të ri se çfarë paskan bërë kinse dikur të parët tanë!

Kështu, mbillet një storie psikologjike në shpirtat e fëmijëve tanë, duke u treguar diçka shumë joadekuatë, diçka pa shije. Pse e bëjnë këtë?

E bëjnë për klikime, përndryshe nuk i

duhet dikujt ky shkrim dhe shkrimet e ngjashme. Duke synuar të sjellin diçka sensacionale, që do merr klikime, portalet sjellin edhe tema të tilla, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me realitetin tonë.

Sikur të kishte ligj të zbatueshëm medial për portalet, me siguri, dikush do ishte dashur të përgjigjej për shkrime të tilla. Sidoqoftë, temat e tilla hyjnë në grupin e shenjave paralajmëruese të fundit të botës, të apokalipsit. Nëse njerëzit e sjellin kiametin, ashtu qysh edhe e cilësojnë literaturat fetare, pak ditë ka kur portalet tona nuk sjellin një tabloid pamjeje ku shkruhet se po vjen kiameti.

NË CILËN DITË DO TË JETË KIAMETI?

Po krijohen qarje të mëdha të tokës. Mentalisht dihet për "qarjen e madhe afrikane", që po e ndanë në dy pjesë Afrikën. Po largohet kontinenti nga kontinenti, duke u matur me mënyra të ndryshme, por të sakta nga NASA dhe kjo distancë e rritur do të zgjasë edhe tutje...

E, çka pastaj?

Në këtë pyetje nuk di kush të përgjigjet, pos fjalëve se po vjen kiameti... fundi i botës...

Sokol Murturi



/perlaluxury_ks.al

Takimi me ish-të dashurën pas 40 vjetësh

Isha nxënëse i Normales në Prishtinë. Në atë kohë, afër banesës sime, jetonte Ajo, gjimnaziste. Ishte në vitin e parë gjimnaz, kurse unë isha maturant në Normale. Me të u njoha nëpërmjet vajzës së axhës së saj. Dhe, miqësia jonë përparoi shpejt, aq sa një ditë qershori u gjendëm në përqaftim të njëri-tjetrit. Por, shpejt edhe u ndamë dhe më nuk u pamë 40 vjet!

Isha maturant në Normale, kurse Ajo gjimnaziste, në vitin e parë. Njohja jonë nuk ishte e rastësishme, meqë me vajzën e axhës së saj isha në gjeneratë. E pyesja

shpesh për të dhe ajo një ditë më tha: "Pse pyet për të? Të pëlqen?". E di se goja mu shtang dhe përgjigje nuk i dhashë. E di se u skuqa në fytyrë dhe u bëra all...

NUK JAM E MËSUAR TË HYJË NË BANESË TË HUAJ!

Dhe, ndodhi si ndodhi, më njohu me të. E, që nga ai moment shoqëria jonë erdhi duke u zgjeruar, aq sa një ditë edhe u pa në derë të banesës ku banoja.

Kur e hapa derën mbeta i shtangur. I thashë të hynte brenda, por ma ktheu se nuk ishte mësuar të hynte në banesë të huaj...

Më tha se profesoresha e gjuhës shqipe ia kishte dhënë referat "Hasta la vista" e Petro Markos dhe librin nuk e gjente dot. I thashë se unë e kam atë libër dhe e kisha lexuar, madje, disa herë...

"Ja, ky është libri "Hasta la vista", i thashë, derisa e mbaja librin në dorë. "Në të ke edhe letra dashurie dhe do i lexosh me ëndje", vazhdova.

"Lumja unë, më ke shkruar letra dashurie?!", foli me zë të lartë.

"Jo, letrat janë të Gortit. Ia ka shkruar Anitës", ia ktheva.

"Do i lexoj dhe do i mësoj përmendësh, pastaj do t'i them ty!", ma ktheu me buzëqeshje.

"Pse mua?!", i thashë më shumë në formë habie.

"Sepse unë nuk njoh tjetër si ty!", ma ktheu me buzëqeshje.

Dhe, pasi e mori librin iku shkallëve teposhtë, duke kthyer disa herë kokën pas...

2 QERSHOR...

Pas një jave ma ktheu librin. Ishte shkas që të takoheshim përsëri apo nuk dëshironte më gjatë ta mbante librin tim? E vërteta doli: Kur ma ofroi librin afër, shpejt e shpejt ma fali edhe një puthje. Kurse, në murin e korridorit gërvishtëm me kompas: 2 qershor.

Nuk patëm më puthje të tjera, meqë vajza e axhës së saj, në shenjë pakënaqësie, i kishte folur se unë kinse jam një aventurist dhe asgjë më shumë...

Dhe, ndodhi si ndodhi, 40 vjet më nuk u takuam kurrë. Ajo kishte shkuar me familje për të jetuar në Gjermani.

Para pesë vjetësh, në ditë pranvere si sot, gati më lëshoi shpirti kur e pash në Prishtinë. Kishte ndryshuar rrënjësisht! Ama disa elemente të fytyrës së saj ishin si të kohës kur edhe ishim puthur.

E ndala në rrugë. U bë sikur nuk më njihje, ani pas një e skuqur all ia përshkoi fytyrën. U ulëm në restorantin më të afërt. Folëm e folëm dhe, pas shumë lutjeve të mia, përfunduam në një motel në periferi të Prishtinës. U munduam ta kompensojmë atë që e kishim humbur në rini...

Dhe, përsëri, pas asaj dite më prapë kurrë nuk u pamë!

S. Rama

Instrumentalisti nga Peja, *Faruk Drenica mahnitë me talentin e tij!*

Talentin e trashëgoi nga babai i tij e që në moshën tre vjeçare ishte e qartë rruga të cilën do ta ndiqte.



I lindur në Gjermani por që tashmë vijon studimet në vendlindjen e tij në Pejë, si dhe është tejet i kërkuar në profesionin e tij madje edhe jashtë kufijve.

E quajnë shkurt Luki, e që nuk i mungojnë bashkëpunimet e shumta me këngëtarët të estradës, por që më së shumti me Ylli Demajn, këngëtarin e njohur poashtu nga Peja.

Karrierën e filloi që në moshën 11 vjeçare e tashmë 15 vite ka performuar si instrumentalist me sint (piano digjitale) dhe vazhdon të jetë tejet i kërkuar në

dasma dhe ahengje, e që zëri i tij ka arritur deri në Australinë e largët.

Vlen të përmenden pjesëmarrjet e shumta në evente televizive për festa të fundvitit ku Farukun e kemi parë shumë herë në RTV21, Op Op Labi party, në KTV e shumë mbrëmje tjera muzikore.

Në profilin e tij @farukofficial1 do t'i gjeni të gjitha detajet rreth mbrëmjeve muzikore si dhe ta kontaktoni për eventet tuaja të ndryshme të cilat sigurisht se me talentin e tij do t'i bëjë të paharrueshme.



Ka 300 mijë euro në bankë, ç'brekë mban!

"Në rrugë gazetarie
çka nuk sheh e çka nuk
dëgjon!
Në lagjen time në Prishti-
në kam një shok gjenera-
te, me të cilin kemi studi-
uar bashkë. Dhe, gjatë
gjithë jetës së tij ka bërë
gjëra interesante, surpriza
të çuditshme, të cilat në
momente të caktuara të
bëjnë të qeshësh..."

Një ditë më thirri në tele-
fon dhe më tha:

"Lizë, po pate kohë dalim
e pimë nga një kafe?"

"Ok", i thashë.

U takuam dhe, pasi na
erdhi kafja, nisëm të bise-
donim.

"Sot kam një surprizë
shumë interesante, por të
tregoj me një kush, të mos
I tregosh askujt!", më tha.

"Ok, në rregull, nuk bise-
doj me njeri!", i thashë.

"Po të tregoj, jo të

lavdërohem, por babai im
në llogarinë e tij bankare
ka 300 mijë euro. E, sot,
teksha shkonte në banjë
arriti fshehurazi t'i bëj një
fotografi; e fotografova
me brekë copa-copa!
Këtë fotografi ia tregova
edhe nënës sime, e cila
nuk u befasua, nuk i erdhi
interesant, por më tregoi
edhe një ngjarje më inte-
resante se kjo:

"Kur jemi martuar, atë
natë, me sytë e mi, e
kam parë se babai yt ka
hyrë dhëndër me brekë
të grisur, prandaj nuk po
habitem!", ma ktheu ajo.

"Babai yt paska ide
të mrekullueshme! Të
mençura, sepse llogarinë
e ka plot, kurse puna e
brekëve në këtë kohë pak
ka rëndësi!", ia ktheva me
qeshje.

Liza Beqaj



*Rama: Lul, ma bën hallall!
Nuk mujta me bë më shumë për ty...*

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android



www.shkabaj.net



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Nga xhelozia apo...

Pse Ronela Hajatin populli e quan balenë?

Ronela Hajati aktualisht ndodhet në Barcelonë, ku do të marrë pjesë në një festë të "Eurovisionit".

Këngëtarja e cila do të përfaqësojë Shqipërinë me këngën "Sekret", është përballur së fundi me një mori komentesh negative sa i takon peshës trupore.

"Sot kemi pre-fest eurovision në Barcelonë. Në një anë këtu kemi njerëz që e dinë këngën për-mendësh, të sjellshëm, gazetarë, njerëz të kujdesshëm... Dhe, nga ana tjetër, kemi popullin tim shqiptar suportues që janë të gjithë nutricionistë dhe për ta jam "lopë", "balenë", vazhdojnë

me dilemat se si një këngëtare që performon mund të dojë një njeri që lexon", thotë ajo. Sidoqoftë, disa herë këngëtarja është përballur me situata të tilla shkakut i peshës, por sigurisht për të diçka kaq sipërfaqësore nuk mund të jetë problematike...



Kompleksi Cima Tower

Rr. Cenë Dugolli, Ferizaj

+383 49 50 90 90

f i www.cimaks.com

*Pranvera është stina
më e bukur për fillimet e reja...!*

Sot edhe fëmija dinë për seksin!

Mua më kishte sjell lejleku në jetë. Nuk di ku më kishte gjetur, por di se në oborrin e shtëpisë sonë më kishte hedhur nga sqepi. As nëna nuk dinte ku më kishte marrë shpendi këmbëgjatë, por dinte se më kishte gjetur në bahçe një mëngjes të hershëm.

Nëna më tregonte si më kishte gjetur mua. Atë moment e përshkruante kështu: "Dielli sapo kishte lind. Dola në oborr për të parë se a ishin rritur shalqinj të gjatë natës. Tek ecja nëpër bahçe të gjeta ty, në mes të shalqinjve. Kur të pash u gëzova shumë, kurse ti qeshe posa të mora në duar. Të solla në shtëpi dhe u gëzuan të gjithë fëmijët e tjerë".

ISHA I LUMTUR QË MË KISHTE GJETUR NJË NËNË SI E IMJA!

Kam jetuar për shumë e shumë vite me atë ndjenjë jetësore. Kam jetuar duke u tretur në mendime sesi më kishte sjell lejleku në bahçen tonë dhe aq më mirë që më kishte gjetur një nënë si kjo, që ma solli Zoti e jeta.

Fëmijët tjerë nuk e kishin pasur këtë fat,

mendoja unë. Ata nuk kishin një mollë sikur unë në arën tonë, që quhej "Molla Xufkë". Nuk kishin as shumë ftonj si ne. Nuk kishin as livadhe me lule si ne, e nuk e kishin as oborrin të pjerrët për t'u rrokullisur siç bëja unë...

Nuk kishin asnjë krua si yni, uji i të cilit shuante etjen e fshatarëve tanë...

PA DASHURI NUK KA FËMIJË...

Kam jetuar me këtë ndjenjë deri kur kuptova se dashuria ishte arsyeja e parë që lindin fëmijët. Po s'e dashurove dikë, nuk do të kesh martesë e as fëmijë. Nëse nuk do kesh dashur dikë, nuk do të pasojnë trashëgimtarët e familjes...

Pra, më vonë kuptova se nëna më kishte gënjyer për lejlekun, por kurrë nuk kisha menduar t'i bëja nënës këtë pyetje, sepse ndoshta ajo do lëndohej.

Pse?

Sepse, në atë kohë pakkush te ne mbillte shalqinj a pjepa, e të mos flasim për dredhëzat që sot i gjen me bollëk kudo.

PO S'DASHUROVE S'KE MARTESË!

Drini ishte në klasën e tretë kur unë u mundova ta imitoja tregimin e nënës sime për lindjen e tij...

"Drin, i thashë, a di sa i bukur ke qenë kur je lindur? Të ka gjetur nëna në kopsht, në mesin e luleve..."

"Pse gënjën, babi?! Mua nuk më keni gjetur në kopsht, por ti dhe mami keni bërë marrëdhënie seksuale dhe prej marrëdhënies suaj kam dal unë. Kështu kemi mësuar në shkollë.

Hë, kë po mundohesh ta bësh budalla, mua a?! Lëri përrallat!", ma ktheu Drini.

S.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamt, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamt.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamtin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do të ndahemi edhe pse duhemi?

Përshëndetje zonja magjistare, jemi çift që duhemi shumë, punojmë në një vend pune. Lidhja jonë shkon aq mirë derisa jemi në punë. Kur jdesi i tij ndaj meje është aq i madh sa nuk di ta përshkruaj. Është njeriu që i kam dhënë gjithçka, por, për çudi, si të largohemi për dy-tri ditë kur nuk shihemi, bëhet i ftohët ndaj meje!

Jemi në lidhje qe shumë vite dhe unë po dua ta mbylli këtë dashuri me një fejesë, por ai heziton. Kur ia përmendi fejesën, ikë nga tema! Kjo po më bën të kem frikë se ne do ta kemi një fund të keq të dashurisë sonë.

A do të fejojemi?

“Unë e ai”

Përgjigje:

Te ai është një dyshim për një person me të cilin ti ke punuar në zyre katër vite. I kanë thënë se ke qenë në lidhje. Prandaj, është në ndjekje e sipër të fakteve dhe unë besoj që ju disa herë e keni hapur atë temë të

së kaluarës suaj...

Nuk do të keni fejesë dhe lidhja juaj do të ndërpritet.

Jeta me dhimbje të përditshme

Jam nënë e dy fëmijëve (17 dhe 19 vjeç). Jetoj jashtë Kosovës. Jetoj me një shqetësim të përditshëm. Më dhemb çdo ditë diku. E, kur shkoj tek mjeku asgjë nuk del keq.

I kam bërë analizat sa e sa herë dhe çdo gjë e kam mirë, e unë nuk ndihem mirë! Djemtë i kam në rrugë të mirë, nuk konsumojnë as duhan e as alkool.

Pse e kam këtë problem?

“Dyshimi”

Përgjigje:

Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem sot, por kështu ke jetuar që nga fëmijëria. De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes.

Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohen nga baza nervore, e që rrjedhë nga e kaluara traumatike. Traumatizmi nuk shërohet posa

ta kalojë njeriu kufirin e BE-së. Brezat tanë jetojnë me trauma dhe kanë nevojë të shërohen... Bota traumatike vazhdon tek çdo kush që prindi i ka treguar diçka nga jeta e vet, sidomos nga periudha e luftës... Në rastin tënd nuk bën punë mjekësia e as jeta klinike, sepse kur je mirë me analiza mjeko-laboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje. Lufta të mbetet ty, prandaj ka shërim alternativ...

Pse nuk po më ecë puna?

Përshëndetje magjistare e nderuar, të uroj shëndet! Jam K. Z., e lindur më 1964. Kam pasur gjithmonë ëndërr të kem punën time e të mos mbetëm amvise dhe mbarova një kurs për frizere. Hapa lokalin tim, por qe pesë vjet nuk më shkon puna.

Pastaj, mora me qira një lokal tjetër në Prishtinë, por as aty nuk u bë puna sikur doja. Tani kam hapur lokalin në shtëpi. A do të kem punë, edhe pse kam stagnuar?

“Jeta”

Përgjigje:

Para së gjithash, ti ke punuar në rrethin tënd dhe klientela është nisur nga parimi i thjeshtë se ti nuk i përmbush aspiratat e tyre. Rrethi ynë gjithnjë e preferon të huajin. Po të kishte qenë dikush nga rrethi tjetër, me siguri, do të kishte pasur punë.

Reklama, propaganda dhe aparatúra sot janë pjesë të

*pandashme të suksesit, për
çka ti nuk i ke në nivel të duhur.
Këto gjëra bëjnë që të mos
përfitosh aq sa të dalësh nga
gjendja që je sot.
Këshilla ime është: Vazhdo me
këtë zanat, sepse do të ndezë
suksesi, por zgjidh hapësirën
dhe bëje një ndryshim...*

Gruaja ime ka ndryshuar!

Zonjë, jam 40-vjeçar, jetoj në Prishtinë. Ka kohë që nuk përjetoj ndjenjën e dikurshme me gruan time. Ajo si me zor më përgjigjet në kërkesat për intimitet bashkëshortor, me vështirësi përgjigjet në pyetjet e mia dhe nuk është ajo që ka qenë dikur.

Po e vërej një ndryshim të madh te ajo, por nuk di pse po ndodh kjo gjë?

"Pa emër"

Përgjigje:

Kishte shkuar një njeri te mjeku dhe i ankohet mjekut: Po më dhemb këtu doktor... I thotë tutje se kurrë nuk më ka dhimb deri më tani...

Mjeku e pyet:

"Sa vjeç je?"

"60", ia kthen.

"Deri më tani kurrë si ke pasur 60 vjet, prandaj tash të dhemb!", ia kthen mjeku.

Desha ta ndërlihd rastin me pyetjen tuaj dhe të them se ju deri më tani kurrë nuk i keni pasur 52 vjet. Tani kanë nis fëmija të marrin vendime dhe ju keni më shumë halle dhe brenga për sjelljen e tyre, lëvizjet e tyre.

Jam e ftohtë në dashuri!

Përsëndetje zonjë, jam e moshës 41-vjeçare. Kam pasur disa lidhje të dështuara. Kam oferta edhe tani, por nuk po mund t'i besoj askujt!

"Zeshkania"

Përgjigje:

Para së gjithash, dikujt duhet t'i besoni. Besimi në këtë rast nuk është diçka që menjëherë ju bën me fat, por as mosbesimi nuk është diçka që ju merr fatin.

Ju duhet t'u përgjigjeni ofertave, por t'u përgjigjeni me biseda dhe marrëveshje për të ardhmen e jo me diçka aventureske.

Pra, besoni në veten tuaj dhe keni bindjen se çdo gjë mund të arrihet edhe përmes komunikimit, nëse personi është i sinqertë. Kur ai është i pasinqertë dhe me qëllime të caktuara, atëherë nuk ju bën dobi as dalja.

Pse jeta pas martese po shkon mbrapsht?

E dashura magjistare, jam një djalë, 28-vjeçar. Kam gati 4 vjet që jam martuar dhe jam shumë në hall.

Qëkur u martova nisi gjithçka mbrapsht: grindje në familje, grindje me bashkëshorten... Ende nuk kemi fëmijë. Kemi provuar të kemi, por pa rezultat.

Çdo derë imja është mbyllur. Nuk më del kismet i as për punë. Pra, krejt mbrapsht... Ju lutem, a kam magji?

"Burri me magji"

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Përgjigje:

Askush më mirë se ti nuk di që je nën magji. Nëse i referohemi një shembulli konkret nëse pacienti shkon te mjeku dhe ai derisa e kontrollon i thotë kështu e ashtu, pacienti më së miri e di nëse është mirë apo nuk është, sepse brenda tij ndodh i tërë problemi. Pra, ai është poligoni ku zhvillohet beteja...

Logjikisht, nëse çdo gjë ka qenë mirë, por ka ndryshuar për të keq prej kur je martuar, kjo ka domethënie të mbrapshtë...

Magjia është një veprim që ndërmerret për ta ndryshuar gjendjen në një shtëpi. Pra, për ta ndryshuar për të keq dhe te ju ka mbështetje ky mendim.

Megjithatë, nuk mund të pohoni me bindje se këtë gjë e ka bërë nusja apo familja e saj. Këtë gjë kanë mundur ta bëjnë edhe në familjen tënde të gjerë apo në rrethin tënd familjar. Por, sidoqoftë, nuk bën të etiketoni askënd pa fakte, sepse ka te ne shumë zona që kanë marrë këtë epitet pa pasur asgjë të keqe në shpirtin e tyre.

Në këtë rast, dëmi dhe mëkati janë të mëdha dhe ata që shpifin pa fakte i bartin përgjegjësitë etiketuese.



Ju do, por nuk ua thotë!

Sipas astrologjisë çdo shenjë ka mbrojtjet e veta dhe tenton të “dëbojë” personin që ka rënë në dashuri me fraza shumë specifike, fraza që nuk mund të përshkruhen vetëm si fjalë të një të dashuruari...

DASHI:

A jam i dashuruar me ty? Më duhet të zgjedh mes kaq shumë gjërave...

DEMI:

Unë me një grua që nuk gatuan më mirë se unë? Kurrë.

BINJAKËT:

Preferoj femrat e një stili tjetër.

GAFORRJA:

Nuk mendoj se më kupton...

LUANI:

Nuk ka lindur ende gruaja që do më bëj të dashurohem...

VIRGJËRESHA:

Mbetesh ekscentrike për shijet e mia.

PESHORJA:

Kapitulli “ish” nuk është mbyllur ende.

AKREPI:

Jo për t’u mburrur, por zgjedhjet janë të shumta...

SHIGJETARI:

Dua lirinë time, nuk më pëlqejnë angazhimet.

BRICJAPI:

Më duket jashtëzakonisht e mërzitshme puna juaj. Nuk e duroj dot.

UJORI:

Je e mërzitshme për shijet e mia.

PESHQIT:

Nuk ka dashuri nëse nuk je e gatshme të heqësh dorë nga gjithçka për mua...



SHERWOOD

Resorts and Hotels



**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA